

**AKT NORMATIV**  
**Nr. 11, datë 27.3.2020**

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 36/1, të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë, me këtë përmbajtje:

“Përfundimisht parashikimeve të nenit 15, të këtij ligji, pagesat e kësteve të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin kryhen pranë bankave të nivelit të dytë dhe Postës Shqiptare, sh.a., për llogari të administratës tatimore, për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2020 brenda datës 20 tetor 2020, ndërsa për tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit 2020 brenda datës 20 dhjetor 2020.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**